



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSQVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 74/14

Nr. i fq. / Br. st -7-

Data: / Datum 27.03.2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

---

**RREGULLORE  
PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR SIGURIMIN E  
STREHIMIT PËR KATEGORITË SOCIALE**

**MARS 2014**

Në bazë të nenit 12 pika "c" dhe nenit 17.1, pika "k" të Ligjit mbi Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-40, neni 41.2 pika "c" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 27.03.2014, miraton këtë:

## **RREGULLORE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR SIGURIMIN E STREHIMIT PËR KATEGORITË SOCIALE**

### **KREU I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe procedura e dhënies së banesës me qira, përdorimit të banesës, kushtet e shfrytëzimit të saj, procedura e vendosjes, kriteret dhe renditja e përparësisë për dhënien e banesës në shfrytëzim me qira, me të cilën disponon Komuna e Vushtrrisë.

#### **Neni 2**

- 2.1. Komuna e Vushtrrisë, si person juridik, ka të drejtë të posedojë pasuri të patundshme dhe objekte banimi qoftë kolektive apo individuale, të destinuara për zgjedhjen e çështjes së strehimit të rasteve sociale dhe të menaxhojë me atë pasuri;
- 2.2. Komuna, u jep në shfrytëzim kategorive sociale, banesat, të cilat janë pronë e komunës, duke respektuar procedurat e përcaktuara me këtë rregullore;
- 2.3. Komuna mund të investojë në ndërtimin e banesave për banim social qoftë me mjete nga fondet e saj, të jetë bashkëinvestuese, apo mund të realizojë ndërtimin e tyre me forma të tjera si: përmes ndihmave financiare ose donacioneve për ndërtimin e objekteve të banimit social, kolektiv apo individual nga subjektet e tjera qoftë juridike, fizike, shoqatave të ndryshme humanitare brenda dhe jashtë komunës apo edhe jashtë vendit - Republikës së Kosovës, të cilat shprehin dëshirën për investime me destinim për raste sociale.

#### **Neni 3**

Banesat e destinuara për strehimin e rasteve sociale me vendim të komunës, ndahen konform kriterëve, kushteve dhe procedurës së përcaktuar me këtë rregullore.



## **KREU II**

### **KUSHTET E DHËNIES SË BANESËS NË SHFRYTËZIM ME QIRA**

#### **Neni 4**

4.1. Banesat sociale ndahen në shfrytëzim me qira, për strehimin e familjeve apo individëve që janë raste sociale për kohë të pacaktuar, me qira simbolike, lartësia e së cilës caktohet nga Kryetari i komunës, në propozim të Komisionit vlerësues për kërkesat e qytetarëve, por që nuk mund ta kalojë qiranë mujore mbi 40 €;

4.2. Pas ndarjes së banesës në shfrytëzim me qira, lidhet kontrata mbi qiranë, në mes qiradhënësit - Komunës së Vushtrrisë, të cilën e përfaqëson Kryetari i komunës dhe përfituesi social, ku konkretisht përcaktohen: kushtet e dhënies me qira, mënyra e shfrytëzimit, qiraja, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve kontraktuese.

#### **Neni 5**

Të drejtën e kërkesës për marrjen e banesës në shfrytëzim me qira e ka kandidati dhe familja e ngushtë e tij/saj, që është banor i Komunës së Vushtrrisë, i cili është rast social apo nuk e ka të zgjedhur çështjen e banimit.

#### **Neni 6**

Përfituesi i banimit social nuk mund ta fitojë të drejtën e pronësisë në objektin e banimit dhe nuk ka të drejtë t'ia tjetërsojë atë personit të tretë, ngase pronësia e komunës është e përhershme.

#### **Neni 7**

7.1. Përfituesi i të drejtës së banimit social, e humb të drejtën në shfrytëzim me qira të objektit të banimit social, në rast se:

7.1.1. E braktis apo nuk banon në të për një kohë të gjatë, jo më shumë se gjashtë muaj;

7.1.2. Nëse gjendja e tij materiale përmirësohet dhe ai ndërkohë bëhet pronar i objektit të banimit në pronësi të tij apo të anëtarëve të ngushtë të familjes, si dhe

7.1.3. Në rast të shkeljes së parimeve që vendosen në kontratën për shfrytëzim me qira të banesës;

7.2. Në rast se komuna merr vendim për marrjen e banesës nga përfituesi, ai detyrohet që brenda 30 ditëve nga data e njoftimit ta lirojë banesën;

7.3. Kandidati i cili ka fituar të drejtën e banimit, mund t'i ndërpritet kjo e drejtë nëse:

7.3.1. Ka dhënë shënime të rrejshme për përfitimin e kësaj të drejte;

7.3.2. Ka shkelur rregullat e shfrytëzimit të banesës dhe detyrimet që përcaktohen në kontratën për shfrytëzim me qira.

**KREU III**  
**KRITERET BAZË PËR DHËNIEN E BANESËS SOCIALE ME QIRA**

**Neni 8**

8.1. Kriteret bazë për të qenë përfitues i të drejtës në shfrytëzim të banesave sociale, janë si vijon:

8.1.1. Që aplikuesi të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

8.1.2. Të jetë banor i Komunës së Vushtrrisë, së paku 5 vitet e fundit;

8.1.3. Të jetë në gjendje të vështirë sociale, person që nuk e ka të zgjidhur çështjen e banimit apo rast social;

8.1.4. Të mos posedojë patundshmëri.

**Neni 9**

9.1. Kriteret për prioritet dhe rangim të dhënies së banesës në shfrytëzimin me qira janë:

9.1.1.	Familjet nën asistencë sociale;	6 pikë
9.1.2.	Familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës;	6 pikë
9.1.3.	Familjet e martirëve;	5 pikë
9.1.4.	Familjet e veteranëve të UÇK-së;	5 pikë
9.1.5.	Familjet e të burgosurve politik;	3 pikë
9.1.6.	Familjet e kryesuarra nga femra;	2 pikë
9.1.7.	Aplikanti është i ve ose i shkorurëzuar;	1 pikë
9.1.8.	Çdo familjar;	1 pikë
9.1.9.	Statusi i veçantë (i verbër, jetim, invalid me shkallë të invaliditetit mbi 40%, etj);	2 pikë
9.1.10.	Banon në kushte të këqija higjienshëndetësore;	2 pikë
9.1.11.	Banon në një banesë rrezik-shembjeje;	2 pikë
9.1.12.	Të ardhurat e famijes janë nga 0 deri në 50 euro në muaj;	6 pikë
9.1.13.	Të ardhurat e famijes janë nga 51 deri në 100 euro në muaj;	5 pikë
9.1.14.	Të ardhurat e famijes janë nga 101 deri 200 euro në muaj;	4 pikë
9.1.15.	Të moshuar, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesit shoqëror;	1 pikë
9.1.16	Çiftet e reja në moshë totale deri në 55 vjeç.	1 pikë



#### **Neni 10**

10.1. Varësisht nga numri i anëtarëve të familjes, banesa mund të jepet në shfrytëzim për:

- 10.1.1. personin e vetëm..... 1 dhomëshe;
  - 10.1.2. personin me 2-4 anëtarë..... 2 dhomëshe;
  - 10.1.3. personin me 5-6 anëtarë..... 3 dhomëshe;
  - 10.1.4. personin me 7 e më tepër anëtarë..... 4 dhomëshe.
- 10.2. Në strukturën e banesës është llogaritur edhe dhoma e ditës.

### **KREU IV**

## **PROCEDURA PËR DHËNIEN E BANESËS SOCIALE NË SHFRYTËZIM ME QIRA**

#### **Neni 11**

11.1. Kryetari i komunës formon:

11.1.1. Komisionin e përkohshëm.

11.2. Kuvendi i komunës formon:

11.2.1. Komisionin për çështje banesore.

#### **Neni 12**

12.1. Komisioni i përkohshëm formohet për shkak të specifikave aktuale të Komunës së Vushtrrisë dhe ka për qëllim evidentimin e pronave të banimit apo banesave, pronar i të cilave është komuna;

12.2. Komisioni i përkohshëm formohet me vendim të Kryetarit të komunës dhe përbëhet prej 5 anëtarëve, përbërja e të cilit në të njëjtën kohë përfaqëson drejtorinë, përmes së cilave lehtësohet regjistrimi i banesave, pronë e së cilave është komuna;

12.3. Detyrat, përgjegjësitë dhe afatet kohore të punës për Komisionin e përkohshëm, përcaktohen në vendimin për formimin e tij nga ana e kryetarit;

12.4. Komisioni i përkohshëm përfundon mandatin, atëherë kur ka bërë evidentimin e të gjitha banesave, pronë e së cilave është komuna, me ç'rast ka evidentuar familjet që jetojnë aktualisht në ato banesa, duke përcaktuar në detaje se cilat familje nuk kanë nevojë t'i shfrytëzojnë më tutje këto banesa, duke obliguar lirin e tyre dhe pasi t'i kenë kthyer në gjendje të rregullt, për t'i dhënë në shfrytëzim me qira, në pajtim me këtë rregullore.

#### **Neni 13**

13.1. Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, formon Komisionin për çështje banesore. Ky komision përbëhet prej 7 anëtarëve, 2 prej të cilëve i propozon Kryetari i komunës, 1 propozohet nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe 4 nga Kuvendi Komunal, në pajtim me përfaqësimin e partive politike, përmes së cilave 4 partitë politike më të mëdha propozojnë nga një asambleist, e të cilët do të jenë anëtarë të këtij komisioni;

- 13.2.** Kryetar i komisionit zgjidhet njëri nga anëtarët e tij, nga vet komisioni, me shumicën e votave;
- 13.3.** Mandati i Komisionit për çështje banesore zgjat sa edhe mandati i anëtarëve të Kuvendit;
- 13.4.** Anëtarët e komisionit nuk mund të jenë kandidatë apo anëtarët e ngushtë të familjes për marrjen e banesës me qira.

#### **Neni 14**

- 14.1.** Komisioni është i obliguar të përpilojë dhe të shpallë njoftimin për dhënien në shfrytëzim të banesës nga fondi i banesave që ka në dispozicion komuna, mënyrën dhe afatin për paraqitjen e kërkesave, si dhe të provave dhe materialeve të tjera të nevojshme;
- 14.2.** Shpallja e njoftimit bëhet përmes faqes zyrtare të komunës dhe përmes tabelës për shpallje publike të komunës;
- 14.3.** Afati i aplikimit është 15 ditë;
- 14.4.** Komisioni pranon kërkesat, shqyrton provat e bashkëngjitura, viziton familjet që kanë parashtruar kërkesën dhe bën poentimin dhe rangimin në pajtim me këtë rregullore;
- 14.5.** Komisioni vlerëson fillimisht kërkesat e familjeve, për të cilat komuna aktualisht paguan qira nga fondi i subvencioneve;
- 14.6.** Në rast se dy apo më shumë kandidatë kanë pikë të barabarta, komisioni do të nxjerrë kritere shtesë për të përzgjedhë përfituesin dhe lidhur me këtë, paraprakisht, do ta njoftojë Kuvendin e Komunës;
- 14.7.** Komisioni përpilon listën e kandidatëve për dhënien e banesës në shfrytëzim dhe të njëjtën ia dërgon Kuvendit për miratim;
- 14.8.** Ndaj Vendimit të Kuvendit mund të ushtrohet padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.

#### **Neni 15**

Komisioni për dhënien e banesave punon në séance. Kryetari i komisionit thërret seancat, udhëheq ato dhe kujdeset për realizimin e konkluzave të miratuara. Gjatë seancave mbahet procesverbali, i cili përmban konkluzat e marra, arsyetimin e secilit rast, një nga një, vendimet e ndara të anëtarëve të komisionit, nëse ka, si dhe çështjet me interes hyjnë në procesverbal, kur këtë e vlerëson komisioni.

#### **Neni 16**

- 16.1.** Kandidati, për marrjen e banesës në shfrytëzim, kërkesës duhet t'ia bashkëngjisë këto prova:
- 16.1.1.** Vërtetim se është banor i Komunës së Vushtrrisë;
- 16.1.2.** Vërtetim se nuk ka pasuri të paluajtshme, banesë-shtëpi në territorin e Komunës së Vushtrrisë;
- 16.1.3.** Certifikatën e gjendjes ekonomike, si dhe certifikatën për të gjithë anëtarët e familjes mbi 18 vjeç;
- 16.1.4.** Certifikatën familjare;



- 16.1.5. Vërtetim mbi të ardhurat personale apo anëtarëve të familjes;  
16.1.6. Dëshmi për kohëzgjatjen e banimit në qendrat kolektive sociale;  
Dokumentet e kërkuara nuk mund të jenë më të vjetra se 6 muaj nga dita e aplikimit;  
16.2. Nëse ka mungesë të provave apo ato janë të paqarta, komisioni do ta ftojë ushtruesin e kërkesës, që në afat prej 8 ditësh, të bëjë plotësimin e tyre;  
16.3. Në bazë të numrit të pikëve përcaktohet lista e kandidatëve.

## **KREU V DISPOZITAT KALIMTARE**

### **Neni 17**

Dispozitat e kësaj rregulloreje do të aplikohen për të gjitha kërkesat për marrjen e banesës me qira.

### **Neni 18**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Inspektime.

### **Neni 19**

Kjo rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

